

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Emra, adresa dhe të dhëna bankare në shitje online/ FBI zbulon "Rydox", tregu ilegal i drejtuar nga dy vëllezër kosovarë
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/emra-adresa-dhe-te-dhena-bankare-ne-shitje-online-fbi-zbulon-rydox-tr-i47367
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 15:08:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 14:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6f66566c9bfa3b9e00185fc0dda6c1091c19c776c5e484d8e75cead485ad9e34
TEKSTI	d32b37ed477c27f852bc24c7a2d1b09b583abb9cab4a2f7f667713baa396bf72
PAMJA	e0c57211fea9fe12c79df9af9c217838ec8940122c38f296bc9c520d1fe8dfbe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	00ab6b8a9870ccf3090368e386c13650059389e89bb035f181461d41980a4106
E MËPARSHMJA	0a4ef2b68bc8c8d98f1a8ebe6cfb11addd0788839f2a82d79028403b7e80ef58
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/00ab6b8a9870ccf3090368e386c13650059389e89bb035f181461d41980a4106>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[“Ndërtimi i projektit të Zvërnecit nuk vendoset në rrugë”! Rama nga Brukseli: Kemi reflektuar për protestën. Dua Lipën e dua, por nuk është Papa!](#)

29 Shtator 2026, 15:41

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
-

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 29 Shtator 2026, 16:55

Emra, adresa dhe të dhëna bankare në shitje online/ FBI zbulon "Rydox", tregu ilegal i drejtuar nga dy vëllezër kosovarë

Hetimi i autoriteteve amerikane kishte nisur në vitin 2022, kur një burim i fshehtë i FBI-së krijoi një llogari në "Rydox" dhe depozitoi 300 dollarë në kriptovalut



Shkruar nga Veritas



Një treg ilegal online, ku shiteshin të dhëna personale dhe bankare të vjedhura, është drejtuar për vite me radhë nga dy vëllezër nga Kosova. Bëhet fjalë për platformën “Rydox”, aktiviteti i së cilës është zbuluar pas një hetimi të FBI-së amerikane.

Sipas dokumenteve gjyqësore amerikane, të siguruara nga Radio Evropa e Lirë, Ardit dhe Jetmir Kutleshi dyshohet se kanë administruar platformën që ofronte të dhëna të vjedhura dhe mjete të përdorshme për mashtrime dhe krime të tjera kibernetike.

Hetimi i autoriteteve amerikane kishte nisur në vitin 2022, kur një burim i fshehtë i FBI-së krijoi një llogari në “Rydox” dhe depozitoi 300 dollarë në kriptovaluta. Më pas, ai bleu rreth 40 paketa me të dhëna të vjedhura.

Në platformë ofroreshin emra, adresa, datëlindje, numra të sigurimeve shoqërore dhe të patentë-shoferëve, të dhëna të kartave bankare, fjalëkalime dhe kredenciale për hyrje në llogari emaili, blerje online dhe platforma takimesh.

Sipas aktakuzës, përdoruesit mund të blinin edhe mjete për dërgimin e mesazheve të padëshiruara, faqe mashtruese dhe materiale që mund të përdoreshin për veprimtari kriminale në internet.

Platforma funksiononte përmes pagesave në kriptovaluta. Për t'u bërë shitës, përdoruesit duhej të paguanin një tarifë, e cila gjatë viteve varionte nga 200 deri në 500 dollarë. Nga çdo shitje, 60% e shumës i kalonte shitësit, ndërsa 40% mbahej nga administruuesit e “Rydox”.

Hetuesit amerikanë ndoqën gjithashtu gjurmët e pagesave në kriptovaluta dhe zbuluan se një pjesë e të ardhurave të platformës përfundonte në kuletat të kontrolluara nga vëllezërit Kutleshi.

Kush janë Ardit dhe Jetmir Kutleshi?

Radio Evropa e Lirë ka siguruar dokumentet gjyqësore amerikane, përfshirë aktakuzën dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që përshkruajnë blerjet e fshehta, gjurmimin e pagesave dhe komunikimet mes administratorëve të tregut ilegal. Ato tregojnë se si funksiononte Rydox, dhe se si u lidh shitja e të dhënave të vjedhura me njerëzit që e drejtonin. Ndonëse hetimi i FBI-së kishte nisur më 2022, Rydox ekzistonte prej vitesh.

Sipas aktakuzës, vëllezërit Kutleshi e administrojnë tregun e paligjshëm të paktën nga shkurti i vitit 2016. Me një ndërprerje në mes të viteve 2019-2020, platforma ekzistoi deri në fund të 2024-tës, kur edhe pushoi së ekzistuari pas operacionit të autoriteteve amerikane.

Në vitin 2024, ndaj dy vëllezërve u ngrit aktakuzë me gjashtë vepra penale. Jetmir Kutleshi e pranoi fajësinë për pikën e tretë të aktakuzës: “Konspiracion për transferimin, posedimin ose përdorimin e një mjeti identifikues”. Ai u dënua më 2025, ndërsa në masën e shpallur iu llogarit koha prej rreth 12 muajsh e mbajtur në paraburgim. Me përfundimin e dënimit, sipas vendimit, ai parashihej të kthehej në Kosovë dhe t'i kufizohet hyrja në SHBA.

Ndërkaq, vëllai i tij, Ardit, e pranoi fajësinë në shtatorin e 2026-tës, për pikën e parë dhe të gjashtë të aktakuzës: “Konspiracion për pastrim parash” dhe “vjedhje e rëndë e identitetit”. Ai pritet ta mësojë dënimin në fillim të vitit 2027. Një shtetas i tretë i Kosovës, Shpend Sokoli, u arrestua në Shqipëri si bashkëpunëtor i vëllezërve Kutleshi, dhe, sipas mediave shqiptare, në majin e 2026-tës u dënua në shkallë të parë me 3 vjet e 8 muaj burgim. Radio Evropa e Lirë tentoi të merrte një koment nga avokati mbrojtës i vëllezërve, si dhe nga vetë Jetmir Kutleshi, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori përgjigje.

Si funksiononte Rydox?

Për përdoruesit, hyrja në Rydox niste me një adresë emaili dhe një llogari. Për t'i blerë produktet, ata duhej fillimisht të depozitonin kriptovaluta. Tregu pranonte kriptovaluta të disa llojeve, duke përfshirë Bitcoin-in. Paratë kalonin në kuletat digjitale, të kontrolluara nga Rydox, ndërsa përdoruesit mund ta shpenzonin gjendjen e llogarisë për produktet e ofruara. Në katalog kishte të dhëna kartelash bankare, fjalëkalime, dhe kredenciale për hyrje në llogari emaili, për blerje online, apo për llogari në uebsajta për takime romantike.

Shiteshin edhe faqe mashtruese, mjete për dërgimin e mesazheve të padëshiruara, si dhe udhëzues për veprimtari kriminale në internet. Paketat që bleu burimi i fshehtë i FBI-së njiheshin si “fullz”. Aktakuza i përshkruan ato si grupe të dhënash identifikuese dhe kredencialesh, që zakonisht përdoren për mashtrime financiare. Pra, blerësit mund të siguronin në një vend të dhëna të vjedhura dhe mjete për t'i përdorur në krime. Dokumentet nuk përcaktojnë çmimin e secilës prej rreth 40 paketave të blera nga burimi i FBI-së - 300 dollarët ishin depozita në llogari, jo domosdoshmërisht shumë e shpenzuar për atë blerje.

Sipas të dhënave në aktakuzë, shtrirja e tregut ishte shumë më e madhe. Për të përfutur nga Rydox, administratorët i kërkonin pagesë edhe atyre që donin të shisnin të dhëna të vjedhura. Sipas aktakuzës, një përdorues duhej të paguante një tarifë të njëjshme për t'u bërë shitës. Gjatë funksionimit të Rydox-it, tarifa luhatej nga 200 deri në 500 dollarë, dhe paguhej në kriptovaluta. Më pas, shitësi e caktonte vetë çmimin e produkteve. Nga çdo shitje, 60 për qind e shumës i takonte shitësit, ndërsa 40 për qind mbahej nga Rydox.

Kështu, tregu siguronte të ardhura si nga tarifat e shitësve, ashtu edhe nga shitjet e tyre. Prapa platformës ilegale kishte edhe punë të përditshme: përgjigje ndaj përdoruesve, pagesa për serverët, përditësime dhe shpërndarje materiale digjitale apo produktesh. Sipas pohimit të agentit të FBI-së, Micah Mayotte, të paraqitur në dokumentin ku kërkohet ekstradimi i vëllezërve nga Kosova, Ardit Kutleshi u përgjigjej kërkesave të përdoruesve, përdorte llogari administrative, dhe paguante domenin dhe shërbimet që e mbanin uebsajtin në funksion.

Jetmir Kutleshi ndihmonte me përditësimin e uebsajtit dhe të serverit, si dhe me një llogari për ruajtjen dhe shpërndarjen e materialeve digjitale. Aktakuza pretendonte, gjithashtu, se të dy përdornin llogari të Rydox-it për të shitur të dhëna të vjedhura për qasje në llogari, faqe mashtruese dhe mjete për mesazhe të padëshiruara. Veprimtaria pati një ndërprerje nga gushti 2019 deri në shtator 2020. Nga komunikimet mes administratorëve dhe një bashkëpunëtori, FBI-i arriti në përfundimin se një atëz asaj periudhe ata ruajtën për ndërkimim dhe përditësimin e uebsajtit.

...nga kompanitë me kontraktues të anë nga kompanitë e tjera që shpesh përdoren në punë për të marrë paraqitjen e shërbimit të shërbimit...

Gjurmimi i parave ishte një tjetër element që FBI-ja përdori për të lidhur Rydnox-in me vëllezërit Kutleshi. FBI tha se një pjesë e të ardhurave kalonte nga kuletat e Rydnox-it në kuletat të kontrolluara nga të pandehurit. Ardit Kutleshi, sipas hetuesve, përdorte të ardhurat e tregut edhe për të paguar serverin dhe shërbime të tjera. Përdorimi i parave të përfituara nga krimi për ta vazhduar veprimtarinë ishte një nga elementet e akuzës për komplot për pastrim parash.

Ndërkohë, blerjet e fshehta në Rydnox nga FBI-ja vazhduan. Më 22 maj 2024, një burim i fshehtë i FBI-së bleu të dhëna identifikuese të një viktime, dhe të dhëna hyrjeje në një llogari me abonim të një viktime tjetër. Të paktën gjashtë viktima të përmendura në aktakuzë janë nga Distrikti Perëndimor i Pensilvanisë. FBI-ja tha se intervistoi viktima për të konfirmuar saktësinë e informacionit, dhe për të verifikuar se të dhënat ishin shitur pa lejen e tyre. Hetuesit analizuan edhe një kopje forenzike të serverit të Rydnox-it. Uebfaqja e Rydnox e bllokuar nga autoritetet amerikane. Por, për t'i lidhur transaksionet me administratorët, hetuesit shqyrtuan edhe llogaritë që ata përdornin jashtë tregut.

Sipas FBI-së, vëllezërit kishin përdorur emrat e vërtetë dhe dokumentet e tyre të identifikimit për të hapur llogari të kriptovalutave. Hetuesit krahasuan adresa emaili dhe numra telefoni. Në llogaritë e tyre gjetën edhe komunikime për administrimin e Rydnox-it, ndarjen e fjalëkalimeve, faturat dhe kërkesat e përdoruesve. Më 12 dhjetor 2024, Ardit dhe Jetmir Kutleshi u arrestuan në Kosovë, me kërkesë të SHBA-së.

Në Shqipëri u arrestua edhe Shpend Sokoli, shtetas i Kosovës, të cilin Departamenti amerikan i Drejtësisë e identifikoi si administrator të tretë të Rydnox-it. Operacioni goditi edhe infrastrukturën e tregut - autoritetet amerikane sekuestruan domenin, ndërsa FBI-ja dhe policia e Malajzisë i sekuestruan serverët e Rydnox-it./REL

/Rel

Poll



AKTUALITET

[247 leje u vulosën nga KKTU gjatë verës/ Nga kullat deri 77 kate në Tiranë deri tek resortet në bregdet, publikohet lista e plotë](#)

29 Shtator 2026, 18:27

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Dyshohet se p*rdhunoi 70-vjeçaren dhe e grabiti në banesë, zbulohet identiteti i fqinjit](#)

29 Shtator 2026, 18:09

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Ndryshime në krye të FSDKSH-së, Spahiu firmos emrin e Suela Popës si drejtuese e re](#)

29 Shtator 2026, 17:22

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Përplasi një 14-vjeçare me motor dhe e braktisi në rrugë, arrestohet i riu në Cërrik](#)

29 Shtator 2026, 17:11

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Shpërthimi në karburantin "ANOIL" në Sarandë/ Prej 3 muajsh i mbyllur, ja çfarë dyshohet se e shkaktoi](#)

29 Shtator 2026, 16:38

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Lëvizte me pistoletë gati për të qëlluar në Tiranë, arrestohet 31-vjeçari](#)

29 Shtator 2026, 16:14

^ekstrakti^





AKTUALITET

Kushtetuesja rrëzon kërkesën e PD për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Endrit Shabani mbetet në detyrë

29 Shtator 2026, 16:04

^ekstrakti^



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.